



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.718/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada - Gllogjani dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fadil Spahiu, kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti politik Lëvizja Vetvendosje (LVV) në Komunën e Lipjanit, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me objekt të çështjes manipulim i votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 27.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.718/2021 e datës 26.10.2021, e paraqitur nga Fadil Spahiu, Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Komunën e Lipjanit, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me objekt të çështjes manipulim i votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 26.10.2021, ka pranuar një ankesë Anr.718/2021 nga Fadil Spahiu, kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Komunën e Lipjanit, më të cilën kërkon që ti rinumërohen votat në vendvotimin 1311e01D, në shkollën fillore “Braca Aksic” në Lipjan. Në vazhdim të ankesës thekson se aryeja e kërkesës për rinumërim të votave në këtë vendvotim është në bazë të publikimeve të formularëve të rezultateve të kandidatve, me të cilën pretendon se në këtë vendvotim në numrin e tij rendor 6 iu janë shënuar vetëm (zero) vota.

Ankesës në cilsi të provës ia ka bashkangjitur deklaratat dhe kopjet e letërnjoftimeve të votuesve me të cilën pretendon se e kan votuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin

e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së Fadil Spahiu, kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Komunën e Lipjanit nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.718/2021 më datën 27.10.2021**

**Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

